

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	U vra nga pronari i shtëpisë që po tentonte të grabiste, identifikohet hajduti shqiptar në Itali! Viktima me precedent penal, kishte një bar në Torino
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/21/u-vra-nga-pronari-i-shtepise-qe-po-tentonte-te-grabist-e-identifikohet-hajduti-shqiptar-ne-itali-viktima-me-precedent-penal-kishte-nje-bar-ne-torino/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:02:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 10:38:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	325dae5bfbb5b4429621d7bfd9182a172dec935849180c6537051aaa507a6e4
TEKSTI	481abe8084ac9bf604eed09cd0059af67def99576a047399038c5174fa6e5e3d
PAMJA	47152e434d8e19ef0befa3b08486fc56d7adfdf528c8e678826a9ca72dfd212f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3b07c138a774ea872da50022e92233cfb56933c6bfc51b1245cb1a3289fc976b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3b07c138a774ea872da50022e92233cfb56933c6bfc51b1245cb1a3289fc976b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

U vra nga pronari i shtëpisë që po tentonte të grabiste, identifikohet hajduti shqiptar në Itali! Viktima me precedent penal, kishte një bar në Torino

Botë

Publikuar: 21/09/2026

f X



Gjovalin Lazri është shqiptari i cili u vra gjatë tentativës së grabitjes në Baldissero d'Alba, në zonën e Cuneos në Itali ku bashkë me të paktën pesë të tjerë hynë në pronën e 35-vjeçarit Roberto Mollo për të vjedhur.

Sipas **versioneve të para** të hetuesve, 36-vjeçari (më herët u raportua se ishte 25 vjeç), kishte hyrë së bashku me disa bashkëpunëtorë në një fermë që ishte në proces rikonstruksioni. Mollo kishte konstatuar praninë e personave që kishin hyrë pa leje dhe kishte qëlluar me një pistoletë gjysmëautomatike. Lazri mbeti i plagosur dhe ndërroi jetë pak më vonë, pavarësisht ndërhyrjes së menjëhershme të personelit mjekësor të urgjencës 118.

Kush ishte viktima

Gjovalin Lazri ishte vendosur prej kohësh në zonën veriore të Torinos, ku jetonte së bashku me partneren dhe djalin e tyre të vogël. Në të njëjtin qytet, në Corso Taranto, çifti drejtonte një bar. Përmes avokates Roberta Sisimbri, familjarët u shprehën se janë "të shkatërruar" nga dhimbja. Avokatja theksoi se 36-vjeçari bënte një jetë të rregullt dhe po bënte përpjekje të konsiderueshme për të kapërcyer problemet e vjetra me drejtësinë: "Po përpiquej në çdo mënyrë të riintegrohej".

Historitë e vjetra me drejtësinë dhe autopsia

Në të kaluarën e Lazrit figuronin disa precedentë për vepra penale kundër pasurisë, megjithëse detajet specifike të rasteve ende nuk janë bërë të ditura nga autoritetet. Për të hedhur dritë

Me të lexuarat

Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë Euro me vlerë /

"Do përfundojmë keq shpirt". Si raportonte kryeagjentja Viora Hyseni te

Benet Becit, si po i pastron paratë e korrupsionit me tanderë n...

te gjithë e dinin në Baku, Viora Hyseni shfaqet në Kosovë dhe dorëzohet te

Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, ...

Shërbime të sigurisë të cilat nga autoritetet për të reaktuar shpejt mbi shkaqet e vdekjes, autoriteti gjyqësor ka urdhëruar kryerjen e autopsisë në kuadër të hetimit të hapur për vdekjen e tij. Trupi i viktimës është transferuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Torino, ku do të kryhen ekzaminimet.

Dinamika e tentativës së grabitjes

Sipas të dhënave të mbledhura deri tani nga hetuesit, Lazri nuk ka vepruar i vetëm. Një grup i përbërë nga katër ose pesë persona dyshohet se kishte vënë në shënjestër fermën e Mollo-s për të vjedhur materiale ndërtimi, ndër të cilat pllaka, çimento, tjegulla, mjete pune dhe skela, me një vlerë totale tregtare prej disa mijëra eurosh. Pronari ndodhej brenda objektit pikërisht për të mbikëqyrur mallrat. I alarmuar nga zhurmat e pazakonta, Mollo mori armën dhe hapi zjarr: një plumb goditi 36-vjeçarin, ndërsa pjesa tjetër e grupit arriti të largohej në këmbë dhe më pas u zhduk me një automjet. Nga kontrollet e para të kryera në pronë rezultoi se në të vërtetë nuk ishte vjedhur asgjë.

/Shqiptarja.com

TAG:

Gjovalin lazri

Të ngjashme



"Absurditet i paimagjinueshëm"/ Netanyahu sulmon Macron pas deklaratave në OKB për Bregun Perëndimor



Trump ende në pushtet, por gara për 2028 ka nisur/ Kush po përgatitet për Shtëpinë e Bardhë?



Kurti takohet me Kaja Kallas: UÇK-ja lindi si përgjigje ndaj spastrimit etnik nga Serbia

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësura me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.